

LIGJ¹
Nr. 9363, datë 24.3.2005

PËR DËRGIMIN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË JASHTË VENDIT, SI DHE PËR MËNYRËN E PROCEDURAT E VENDOSJES DHE KALIMIT TË FORCAVE USHTARAKE TË HUAJA NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË²

(ndryshuar me ligjin nr. 10 218, datë 4.2.2010; me ligjin nr. 175/2013, datë 12.12.2013; me ligjin nr. 119/2016, datë 24.11.2016; me ligjin nr. 85/2023, datë 2.11.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 12 pika 3, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

(ndryshuar me ligjin nr. 119/2016, datë 24.11.2016)

Ky ligj rregullon rastet, mënyrën dhe procedurat e pjesëmarrjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunimin ushtarak ndërkombëtar, brenda dhe jashtë vendit, duke respektuar Kushtetutën, Kartën e Kombeve të Bashkuara, Traktatin e Atlantikut të Veriut, dokumentet e sigurisë së Bashkimit Europian dhe marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Bashkëpunimi ushtarak ndërkombëtar

(ndryshuar shkronja “ç” dhe shtuar shkronja “d” në pikën 1 me ligjin nr. 119/2016, datë 24.11.2016; ndryshuar togfjalësh në shkronjën ç të pikës 1 me ligjin nr. 85/2023, datë 2.11.2023)

1. Për qëllimet e këtij ligji, me pjesëmarrje në bashkëpunimin ushtarak ndërkombëtar kuptojmë:

- a) pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionet ushtarake ndërkombëtare;
- b) pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në stërvitjet ose veprimtaritë ushtarake ndërkombëtare;
- c) qëndrimin e përkohshëm dhe kalimin tranzit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke ndjekur procedurat e përcaktuara në këtë ligj;
- ç) pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misione dhe

² Ligji nr. 9363, datë 24.3.2005 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 29, datë 3.5.2005.

Ligji nr. 10 218, datë 4.2.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 15, datë 25.2.2010.

Ligji nr. 175/2013, datë 12.12.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.209/2013, datë 8.1.2014.

Ligji nr. 119/2016, datë 24.11.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 263, datë 7.12. 2016.

Ligji nr. 85/2023, datë 2.11.2023 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.175, datë 6.12.2023

operacione humanitare ndërkombëtare dhe emergjencash civile.

d) pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në strukturat e Organizatës së Atlantikut të Veriut, të Bashkimit European, në organizatat ndërkombëtare dhe shtabet ushtarake ndërkombëtare.

2. Kuvendi i Shqipërisë me ligj mund të vendosë që Republika e Shqipërisë të marrë pjesë edhe në forma të tjera bashkëpunimi ushtarak ndërkombëtar.

3. Rregullimet e bëra nga ky ligj nuk zbatohen për atashetë ushtarakë shqiptarë, të akredituar në një shtet të huaj, dhe për vartësit e tyre, si dhe për atashetë ushtarakë të shteteve të tjera, të akredituar në Republikën e Shqipërisë, dhe për vartësit e tyre.

Neni 3

Operacionet ushtarake ndërkombëtare

(Shtuar fjalë në pikën 3, me ligjin nr. 10 218, datë 4.2.2010; ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 119/2016, datë 24.11.2016)

Për qëllime të këtij ligji, operacione ushtarake ndërkombëtare janë:

1. Operacionet e vetëmbrojtjes kolektive, që kryhen në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara me ligj e të bazuara në të drejtat e njohura nga neni 51 i Kartës së Kombeve të Bashkuara, ose për të përmbushur detyrime të tjera ligjore, si dhe operacionet e vetëmbrojtjes kolektive, në kuadër të nenit 5, të Traktatit të Atlantikut të Veriut.

2. Operacionet ushtarake, që kryhen për të mbajtur dhe rivendosur paqen, në përputhje me kapitujt VI e VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, si dhe operacione të tjera ushtarake, të ndërmarra në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj.

3. Operacionet ushtarake ndërkombëtare të organizuara, të autorizuar ose të drejtuara nga Organizata e Atlantikut të Veriut (NATO) apo nga Bashkimi European.

Neni 4

Delegimi dhe pranimi i autoritetit të komandimit

(Shtuar fjalë një paragraf me ligjin nr. 10 218, datë 4.2.2010, ndryshuar me ligjin nr. 119/2016, datë 24.11.2016)

1. Autoriteti kompetent, sipas ligjit përkatës për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për qëllime të bashkëpunimit ushtarak ndërkombëtar, mund t'i transferojë pjesë të autoritetit të vet komandantit ushtarak të strukturave të Traktatit të Atlantikut të Veriut, të një shteti të huaj ose një organizate ndërkombëtare. Në të njëjtën mënyrë, autoriteti kompetent shqiptar mund të pranojë një autoritet që i jepet nga një komandant ushtarak i strukturave të Traktatit të Atlantikut të Veriut, i një shteti të huaj ose nga një organizatë ndërkombëtare.

2. Autoriteti kompetent për dërgimin e njësive ushtarake në operacione ushtarake ndërkombëtare, në çdo rast, në aktin e dërgimit duhet të përcaktojë misionin dhe mandatin e këtyre forcave. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, në zbatim të misionit dhe mandatit të përcaktuar, miraton rregullat e angazhimit për këto njësi ushtarake.

KREU II

OPERACIONET USHTARAKE NDËRKOMBËTARE JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 5

Pjesëmarrja e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionet e vetëmbrojtjes kolektive

1. Kuvendi i Shqipërisë vendos me ligj pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionet e vetëmbrojtjes kolektive, sipas pikës 1 të nenit 3 të këtij ligji, me:

a) ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, që përmbajnë dhe shprehin parimin e operacioneve të vetëmbrojtjes kolektive;

b) miratimin, rast pas rasti, në mungesë të marrëveshjeve. ndërkombëtare, të përcaktuara në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni.

2. Këshilli i Ministrave, në mbështetje të pikës 1 të këtij neni, vendos, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, pjesëmarrjen në operacionet e vetëmbrojtjes kolektive të njësive të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

3. Presidenti dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë njoftohen paraprakisht për vendimet e përmendura në pikën 2 të këtij neni.

Neni 6

Pjesëmarrja e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionet ushtarake ndërkombëtare

(ndryshuar pika 5 me ligjin nr. 119/2016, datë 24.11.2016)

1. Kuvendi i Shqipërisë, vendos me ligj pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 3 të këtij ligji, rast pas rasti, duke përcaktuar misionin dhe nivelin e pjesëmarrjes, përveçse kur është përcaktuar ndryshe nga një marrëveshje ndërkombëtare.

2. Këshilli i Ministrave vendos për statusin dhe mënyrat e pjesëmarrjes së njësive të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionet ushtarake ndërkombëtare të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Presidenti dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë njoftohen menjëherë për vendimet e përmendura në pikën 2 të këtij neni.

4. Ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që shërbejnë në operacionet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, gëzojnë përfitime sociale, sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rasteve kur ky ligj ose një marrëveshje ndërkombëtare, e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, shprehen ndryshe.

5. Këshilli i Ministrave, me vendim, mundëson lidhjen e një kontrate sigurimi në dobi të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që përmbush qëllimet e përcaktuara në nenin 3, të këtij ligji, e cila garanton pagesën në rast vdekjeje dhe dëmtimi shëndetësor. Kontrata e sigurimit bëhet edhe për personelin e Forcave të Armatosura pjesëmarrës në stërvitje, sipas shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 2, si dhe për personelin e strukturave të përcaktuara në nenin 10, të këtij ligji, për kohën që dislokohet në zonë operacioni ushtarak.

Neni 7

Operacionet ushtarake ndërkombëtare të organizuara, të autorizuar ose të drejtuar nga NATO-ja apo Bashkimi Europian

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 218, datë 4.2.2010)

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, vendos për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionet e përcaktuara në pikën 3 të nenit 3 të këtij ligji, rast pas rasti, duke përcaktuar misionin, nivelin e pjesëmarrjes, kohëzgjatjen e këtij operacioni, si dhe çdo element tjetër të domosdoshëm për mbarrëvajtjen e operacionit ushtarak.

2. Dërgimi i njësive ushtarake shqiptare, sipas këtij neni, bëhet vetëm në rastet kur, paraprakisht, është arritur një marrëveshje ndërkombëtare për statusin e forcave ushtarake

shqiptare në vendin ku kryhet operacioni ushtarak.

Neni 8

Stërvitjet ushtarake ndërkombëtare

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 10 218/2010, datë 4.2.2010)

1. Për qëllime të bashkëpunimit ushtarak ndërkombëtar dhe për përgatitje të mbrojtjes kombëtare, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë mund të marrin pjesë në stërvitjet ushtarake ndërkombëtare, që zhvillohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ose në veprimtari të tjera të organizuara, të autorizuar apo të drejtuara nga NATO-ja ose nga vende anëtare të marrëveshjes Pfp SOFA.

2. Vendimi për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në stërvitje e në veprimtari ushtarake ndërkombëtare jashtë vendit merret:

- a) deri në nivel kompanie, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes;
- b) mbi nivel kompanie, me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Institucionet vendimmarrëse, të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, njoftojnë, paraprakisht, Presidentin e Republikës dhe autoritetet eprore të komandimit e të drejtimit.

Neni 9

Vendimi për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misione dhe operacione humanitare ndërkombëtare dhe emergjencash civile

(Hequr fjalë në pikën 1 dhe shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 10 218, datë 4.2.2010; ndryshuar togfjalësh në titull të nenit dhe në pikën 1 me ligjin nr. 85/2023, datë 2.11.2023)

1. Vendimi për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misione dhe operacione humanitare ndërkombëtare dhe emergjencash civile jashtë vendit merret nga Këshilli i Ministrave.

2. Shfuqizuar.

Neni 9/1

Dalja e mjeteve të Forcave të Armatosura jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

(shtuar me ligjin nr. 119/2016, datë 24.11.2016)

Mjetet fluturuese, mjetet lundruese, mjetet e transportit dhe të blinduara tokësore, që u përkasin Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, dalin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për qëllimet e këtij ligji, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

Neni 10

Emërimi i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në strukturat e Organizatës së Atlantikut të Veriut, të Bashkimit European, në organizatat ndërkombëtare dhe shtabet ushtarake ndërkombëtare

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 218/2010, datë 4.2.2010 dhe me ligjin nr. 119/2016, datë 24.11.2016)

1. Personeli i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë emërohet në strukturat e Organizatës së Atlantikut të Veriut, të Bashkimit European, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

2. Personeli i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i emëruar në strukturat e Organizatës së Atlantikut të Veriut, të Bashkimit European, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare, në përmbushje të kërkesave të pozicionit të punës apo të

komandës ku është angazhuar, mund të dislokohe në zonë operacioni ushtarak, për periudha kohore jo më shumë se 30 ditë, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

KREU III
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR NË TERRITORIN
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 11

**Qëndrimi i forcave të huaja ushtarake në territorin
e Republikës së Shqipërisë**

(ndryshuar togfjalësh me ligjin nr. 85/2023, datë 2.11.2023)

Forcat ushtarake të huaja mund të qëndrojnë përkohësisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas procedurave të vendosura në këtë ligj, nëse kanë si qëllim:

- a) pjesëmarrjen në operacionet e vetëmbrojtjes kolektive, të ndërmarra në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas pikës 1 të nenit 3 të këtij ligji;
- b) pjesëmarrjen në operacione të tjera ndërkombëtare ushtarake, të ndërmarra në përputhje me pikën 2 të nenit 3 të këtij ligji;
- c) pjesëmarrjen në bashkëpunimin ushtarak ndërkombëtar, të ndërmarrë në përputhje me pikën 3 të nenit 3 të këtij ligji;
- ç) pjesëmarrjen në stërvitjet dhe në veprimtaritë ushtarake ndërkombëtare;
- d) pjesëmarrjen në veprimtaritë e shtabeve ushtarake ndërkombëtare;
- dh) kalimin tranzit të forcave ushtarake të huaja, me lejen e një autoriteti kompetent të Republikës së Shqipërisë;
- e) operacione të tjera ushtarake, përfshirë edhe projekte të përbashkëta mbrojtjeje, me miratimin e autoriteteve kompetente të Republikës së Shqipërisë;
- ë) misione dhe operacione humanitare ndërkombëtare dhe emergjencash civile brenda vendit.

Neni 12

**Dhënia e lejeve të qëndrimit forcave ushtarake të huaja për pjesëmarrje
në operacionet ushtarake ndërkombëtare të kryera në territorin
e Republikës së Shqipërisë**

1. Dhënia e lejes forcave ushtarake të huaja për qëndrim të përkohshëm, për pjesëmarrje në operacione kolektive të vetëmbrojtjes ose në operacione ushtarake ndërkombëtare, të ndërmarra në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas pikave 1 e 2 të nenit 3 të këtij ligji, bëhet:

- a) me ligj nga Kuvendi, në mungesë të një marrëveshjeje ndërkombëtare, që mishëron parimet e vetëmbrojtjes kolektive;
- b) me vendim të Këshillit të Ministrave, për operacionet që ndërmerren sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë dhe shtete të tjera janë palë, dhe Kuvendi, me ligj, ia ka deleguar këtë kompetencë Këshillit të Ministrave.

2. Procedura e përcaktuar në këtë nen zbatohet edhe gjatë qëndrimit të përkohshëm të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëse qëllimi i qëndrimit të përkohshëm është të marrin pjesë në operacionet ushtarake ndërkombëtare, të ndërmarra në territorin e një shteti tjetër.

Neni 13

**Operacionet ushtarake ndërkombëtare të organizuara,
të autorizuar ose të drejtuara nga NATO-ja apo Bashkimi European**

Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave, vendos, brenda 7 ditëve nga data e bërjes

së kërkesës, për dhënien e lejeve forcave ushtarake të huaja për pjesëmarrje në operacionet e përcaktuara në pikën 3 të nenit 3 të këtij ligji, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, rast pas rasti.

Neni 14

Dhënia e lejeve të qëndrimit të përkohshëm forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë në raste të tjera

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 10 218/2010, datë 4.2.2010)

1. Vendimi për pjesëmarrjen e forcave ushtarake të huaja në stërvitje të përbashkëta ushtarake ndërkombëtare, në veprimtari të organizuara, të autorizuar ose të drejtuara nga NATO-ja apo nga vendet anëtare të Pfp SOFA-s në territorin e Republikës së Shqipërisë, për numër të përgjithshëm pjesëmarrësish, merret:

- a) deri në 100 veta, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes;
- b) deri në 500 veta, me vendim të Këshillit të Ministrave;
- c) mbi 500 veta, me ligj nga Kuvendi.

Për stërvitjet që zgjasin mbi 30 ditë, autoriteti kompetent për dhënien e këtyre lejeve është Kuvendi.

2. Për zbatimin e projekteve dhe të programeve të ndihmës dhe të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, dhënia e lejes për qëndrim të përkohshëm, në zbatim të marrëveshjeve të ratifikuara nga Kuvendi, bëhet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

3. Institucionet vendimmarrëse, të përcaktuara në këtë nen, njoftojnë, paraprakisht, Presidentin e Republikës dhe autoritetet eprore të komandimit e të drejtimit.

Neni 15

Vendimi për pjesëmarrjen e forcave ushtarake të huaja në misione dhe operacione humanitare dhe emergjencash civile në territorin e Republikës së Shqipërisë

(Ndryshuar pika 1 dhe shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 10 218/2010, datë 4.2.2010; ndryshuar togfjalësh në titull të nenit dhe në pikën 1 me ligjin nr. 85/2023, datë 2.11.2023)

1. Këshilli i Ministrave, vendos për pjesëmarrjen e forcave ushtarake të huaja në misione dhe operacione humanitare dhe emergjencash civile në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Shfuqizuar.

Neni 16

Kalimi tranzit i forcave ushtarake të huaja

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 10 218, datë 4.2.2010; ndryshuar pika 4 me ligjin nr. 85/2023, datë 2.11.2023)

1. Për qëllimet e këtij ligji, me "tranzit" kuptohet kalimi i forcave ushtarake të huaja për në territorin e një shteti tjetër, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Dhënia e lejes së tranzitimit për forcat ushtarake të vendeve anëtare të NATO-s dhe vendet anëtare të Pfp SOFA bëhet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes. Urdhri u bëhet i ditur menjëherë autoriteteve përkatëse, të cilat marrin të gjitha masat për mundësimin sa më të shpejtë të tranzitimit. Kur shtetet, që kërkojnë lejen për tranzitim për forcat e tyre ushtarake, nuk janë anëtare të NATO-s apo vende anëtare të Pfp SOFA, dhënia e lejes së tranzitimit bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Kërkesës për kalimin tranzit të forcave ushtarake të huaja nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë duhet t'i bashkëlidhet edhe miratimi zyrtar i shtetit, për ku janë drejtuar këto forca.

4. Forcat ushtarake të huaja gjatë kalimit transit nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë shoqërohen nga Policia Ushtarake e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, nëse kërkohet nga shteti përkatës.

5. Presidenti i Republikës dhe Kuvendi njoftohen, paraprakisht, për kërkesën për kalimin tranzit. Kuvendi mund t'i shfuqizojë lejkalimet e lëshuara sa më sipër, t'i zëvendësojë ose t'i ndryshojë ato.

Neni 17

Procedurat e mbërritjes, të qëndrimit dhe të largimit të forcave ushtarake të huaja nga territori i Republikës së Shqipërisë

1. Pjesëtarëve të shërbimit të forcave ushtarake të huaja, kur hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, mund t'u kërkohej dokumentet e mëposhtme:

a) pasaporta ose karta zyrtare e identifikimit personal, me fotografi, e lëshuar nga shteti dërgues, ku shënohen emri, data e lindjes, pozita, numri (nëse ka) dhe lloji i shërbimit;

b) urdhri për lëvizje, kolektiv ose individual, i lëshuar në gjuhën e shtetit dërgues, si dhe në anglisht e frëngjisht, nga institucioni përkatës i shtetit apo organizatës dërguese, e cila vërteton statusin e individit ose të grupit, si pjesëtarë të një force dhe të një urdhri për lëvizje.

2. Personeli civil, që shoqëron forcën ushtarake të huaj ose vartësit e tyre duhet të mbajë pasaportën apo një dokument identifikimi të pranuar.

3. Pjesëtarëve të forcave ushtarake të huaja, në hyrje të territorit të Republikës së Shqipërisë mund t'u kërkohej të paraqesin një certifikatë shëndetësore zyrtare, të lëshuar nga autoritetet e tyre, në përputhje me rregullat ndërkombëtare, të njohura dhe të pranura nga autoritetet shqiptare, me të cilën të vërtetojnë se nuk janë të prekur nga sëmundje infektive.

4. Nëse siguria dhe rendi publik i shtetit shqiptar rrezikohen nga një pjesëtar i forcave ushtarake të huaja, ushtarak ose civil, organi kompetent i shtetit shqiptar, kryesisht ose me kërkesë të personit të interesuar, kërkon largimin e menjëhershëm të tij. Në marrëveshjet për statusin e forcave autoritetet e shtetit dërgues plotësojnë kërkesa të tilla largimi dhe sigurojnë pranimin e pjesëtarit në territorin e këtij shteti.

Neni 18

Regjistrimi

1. Pjesëtarët e forcave ushtarake të huaja, si subjekte që u nënshtrohen formaliteteve të përcaktuara në legjislacionin shqiptar në fuqi, përjashtohen nga detyrimet për vizat dhe kontrolli i imigrimit, kur hyjnë apo dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë. Ata përjashtohen, gjithashtu, nga rregullat për regjistrimin dhe kontrollin e të huajve në zyrat e regjistrimit, në pikat e kalimit të kufirit.

2. Për regjistrimin në hotele, në shtëpitë e pushimit, në spitale, në infermieri ose në mjedise të njëjta apo të ngjashme, si dhe për marrjen e së drejtës për rezidencë ose banim të përhershëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, zbatohen rregullat e përgjithshme dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

3. Pjesëtarët e forcave ushtarake të huaja dhe vartësit e tyre përjashtohen nga procedurat e imigrimit, të përcaktuara në legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 19

Procedurat për dhënien e lejeve për mjetet ushtarake

(Ndryshuar pika 2 dhe 3 me ligjin nr. 175/2013, datë 12.12.2013; ndryshuar togfjalësh me ligjin nr. 85/2023, datë 2.11.2023)

1. Dhënia e lejeve për automjetet ushtarake të huaja, që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes ose të një personi të autorizuar prej tij.

2. Dhënia e lejeve për avionët dhe mjetet e tjera fluturuese, që u përkasin forcave ushtarake të huaja, për hyrjen në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë, si dhe për uljen e

fluturimin, bëhet me urdhër të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe të ministrit përgjegjës për transportin ose nga personi i autorizuar prej tyre.

3. Dhënia e lejeve për anijet dhe mjetet e tjera lundruese, që u përkasin forcave ushtarake të huaja, për hyrjen në hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë, si dhe për ankorimin dhe futjen në portet tregtare, bëhet me urdhër të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe të ministrit përgjegjës për transportin ose nga personi i autorizuar prej tyre, ndërsa për ankorimin në portet ushtarake të Republikës së Shqipërisë, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

4. Këshilli i Ministrave vendos për rastet dhe procedurat për dhënien e lejeve për mjetet ushtarake të huaja, për hyrjen në territorin ose në ujërat e brendshme territoriale të Republikës së Shqipërisë dhe dhënien e lejeve për avionët e mjetet e tjera fluturuese, që u përkasin forcave ushtarake të huaja, për hyrjen në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë, për uljen e fluturimin e tyre, si dhe për raste të veçanta.

5. Lejet e përcaktuara në këtë nen mund të jenë të vlefshme për një ose më shumë hyrje.

KREU IV

STATUSI I FORCAVE USHTARAKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FORCAVE USHTARAKE TË HUAJA

Neni 20

Marrëveshjet për statusin e forcave ushtarake

1. Republika e Shqipërisë, mbështetur në legjislacionin në fuqi, mund të nënshkruajë dhe të miratojë marrëveshje ndërkombëtare, për t'u dhënë status ligjor Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që shkojnë në një vend tjetër, ose forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Këshilli i Ministrave miraton rregullat për zbatimin e marrëveshjeve për statusin e këtyre forcave.

3. Ministri i Mbrojtjes nënshkruan marrëveshje teknike, për të lehtësuar zbatimin e marrëveshjeve për statusin e këtyre forcave.

4. Anëtarët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (përfshirë edhe personelin civil) dhe vartësit e tyre, kur janë në territorin e një shteti të huaj, janë subjekt i ligjit shqiptar, për sa kohë kjo është në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

5. Anëtarët e një force ushtarake të huaj dhe vartësit e tyre janë subjekt i ligjit shqiptar, kur janë në territorin e këtij të fundit, përveçse kur shprehet ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare dhe në rregullat e parimet e pranuar të legjislacionit ndërkombëtar.

6. Në kuptim të këtij ligji, një person është vartës nëse:

- a) është identifikuar si i tillë në dokumentin e tij/saj të udhëtimit;
- b) statusi i tij/saj është përcaktuar si i tillë në një marrëveshje ndërkombëtare;
- c) statusi i tij/saj si vartës konfirmohet nga shteti, shtetësinë e të cilit ai/ajo ka, ose nga shteti nga vijnë këto forca ushtarake të huaja.

Neni 21

E drejta e ushtrimit të juridiksionit

Autoriteve të autorizuar nga shteti dërgues i forcave ushtarake të huaja u jepet e drejta të ushtrojnë juridiksionin, disiplinor dhe penal, mbi pjesëtarët e forcave ushtarake dhe vartësit e tyre, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nëse kjo e drejtë u jepet nga ligji i shtetit dërgues të forcës ushtarake të huaj, për sa kjo është në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, me parimet dhe rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, të pranuar nga Republika e Shqipërisë.

Neni 22
Zgjidhja e ankesave

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, përcakton procedurat për zgjidhjen, dëmshpërblimin dhe heqjen dorë nga pretendimet jokontraktore, që lindin nga bashkëpunimi ushtarak ndërkombëtar.

2. Ky nen nuk zbatohet për bashkëpunimin ushtarak ndërkombëtar të përmendur në nenin 3 të këtij ligji.

Neni 23
E drejta e mbajtjes së uniformës

Pjesëtarët e forcës ushtarake të huaj në kufi, gjatë kalimit tranzit dhe qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë mbajnë uniformë, përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshje.

Neni 24
Vlefshmëria e licencave dhe e patentave

1. Patenta, licenca e fluturimit, licenca e lundrimit dhe licencat e tjera, lëshuar anëtarëve të forcave ushtarake të huaja ose vartësve të tyre nga një shtet i huaj, janë të vlefshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me procedurat dhe qëllimet e këtij ligji.

2. Ministria e Mbrojtjes, nëse është e nevojshme, u kërkon autoriteteve kompetente të forcave ushtarake të huaja të konfirmojnë vlefshmërinë e licencave e të patentave, të përmendura në pikën 1 të këtij neni.

Neni 25
Përrjashtimi nga regjistrimi i mjeteve të forcave ushtarake të huaja

Në vijim të procedurës dhe të qëllimeve të përcaktuara nga ky ligj, mjetet, që u përkasin forcave ushtarake të huaja, të cilat janë të regjistruara në shtetin e huaj dhe mbajnë numër të lëshuar nga ky shtet, përjashtohen nga regjistrimi në Republikën e Shqipërisë.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 26

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 27

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4537, datë 13.4.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**